

TERMAT E REFERENCËS

1. Objekti i Kontratës

Asistence Teknike, Trajnim, Projektim, Zhvillim dhe Shërbim i Sistemit te Integruar Web-Gis, për Menaxhimin e Aseteve te Ngurtësuara, dhe Procesit te Faturimit ne SH.A. Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë.

2. Qëllimi i shërbimeve

Qëllimi i përgjithshëm dhe kryesor që ka SH.A.Ujësjiellës Bulqizë është të ngrejë në stadi moderne nivelin e menaxhimit të proceseve të punës, me qëllim rritjen e cilësinë të shërbimit ndaj qytetarëve duke menaxhuar në mënyrë efektive burimet financiare të Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë.

Qëllimet specifike që lidhen me objektin e kësaj kontrate janë si më poshtë:

- a) Të realizojë rregullorë dhe standarde të plota me qëllim inventarizimin e plote të asetëve nëntokësore dhe mbitorësore të ujësjiellës kanalizimeve në të gjithë territorin e bashkisë, duke përfshirë edhe hartografimin e tyre
- b) Të realizojë rregulla dhe standarde me qëllim mirëmbajtjen e vazhdueshme të inventarit të plote të asetëve me qëllim strategjik të llogaritjes së saktë të vlerës ekonomike dhe teknike të tyre me qëllim përcaktimin e drejtë të prioriteteve të investimeve
- c) Nëpërmjet bazave të të dhënave GIS të mundësojë llogaritjen e parametrave teknike të nevojshëm me qëllim mirë menaxhimit në aspektin teknik dhe mirë projektimin e rrjeteve të ujësjiellës -kanalizimeve, nga pikëpamja e defekteve, llogaritjes së presioneve etj.
- d) Nëpërmjet sistemit GIS dhe hartave nga fotografimet ajrore të kontrollojë gjeografikisht shpërndarjen e klientëve të Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë, me qëllim kontrollin hapësinor si të plotësimit të nevojave të popullatës ashtu edhe eliminimin e abuzimeve me ujë të pijshëm.
- e) Nëpërmjet teknologjive GIS dhe GPS të kontrollojë e monitorojë aktivitetin e punonjësve të Ujësjiellës Bulqizë si në procesin e faturimit e kontraktimit të klientëve ashtu edhe në procesin e mirëmbajtjes së rrjetit fizik të ujësjiellës kanalizimeve.
- f) Të kontrollojë në mënyrë hapësinore procesin e faturimit dhe procesin e pagesave me qëllim marrjen e masave të duhura në funksion të uljes së humbjeve të Ujësjiellës Bulqizë
- g) Të lehtësojë punën e punonjësve të Ujësjiellës Kanalizimeve Bulqizë dhe si rrjedhim të ulë kostot e ndërmarrjes duke aplikuar teknologjitë moderne të informacionit

3. Përshkrim i përgjithshëm i situatës.

SH.A. Ujësjiellës Kanalizme Bulqizë, nuk ka të aplikuara deri tani teknologji moderne informacioni apo programe kompjuterike të projektuara për të mirëmbajtur të dhëna dixhitale si të aseteve ashtu edhe të proceseve të faturimit. Specialiste të veçuar përdorin programe kompjuterike të tipit auto-CAD në funksion të realizimit të projekteve të veçuara të rrjeteve, por jo që të kujdesen për hartografi të të gjithë aseteve dhe në të gjithë territorin e Bashkisë sonë. Vërejmë se në arkivat e UK Bulqizë gjenden disa harta të vjetra të rreth 25-30 viteve me pare tecilat nuk janë përditësuar që prej asaj kohe. Aftësitë dhe mundësitë e UK Bulqizë nuk premtojnë që në të mund të vazhdojmë të mendojmë se mund të inventarizojmë asetet ende me ane të hartografisë manuale, e cila gjithashtu vërejmë se kufizohet vetëm në qendrën e banuar por nuk shtrihet në të gjithë territorin dhe fshatrat e bashkisë.

Duhet të merret në konsideratë nga ofertuesit që në UK Bulqizë kemi njohës por nuk kemi përdorues të teknologjive apo programeve GIS të informacionit. Në jemi në dijeni që ASIG shërben me harta dhe ortofoto për gjithë territorin e Shqipërisë. Disa specialiste i përdorin këto shërbime të ASIG por thjesht në funksion të njohjes së territorit, por jo në funksion të përdorimit të tyre me qëllimin e inventarizimit dhe hartografimit të aseteve tona.

Në lidhje me asetet kompjuterike “hardware”, vërejmë se gjendja në UK Bulqizë është e varfër. Përveç kompjuterëve tip desktop që funksionojnë të veçuar nuk kemi kompjuter apo server me cilësi teknike të tilla për të mbështetur sisteme serioze që menaxhojnë e mirëmbajnë baza të dhënash siç kjo që në pretendojmë të krijojmë.

4. Shtrirja e shërbimeve të UK Bulqize dhe të dhëna të tjera.

Sipërfaqja e Bashkisë është 65822 Ha

Numri i njësive administrative është 8

Numri i Fshatrave është 66

Popullsia aktuale e Bashkisë Bulqize është afërsisht 42100 banorë

Numri i përgjithshëm i punonjësve të SH.A. UK Bulqizë është 60

Numri i personelit teknik (inxhinierë dhe teknike mirëmbajtje është 4

Numri i faturistëve të SH.A. UK Bulqizë është 9



5. Përmbajtja e ofertës teknike

Ofertuesit janë të lire të realizojnë që ofertë teknike ashtu siç e mendojnë ata por në funksion të vlerësimit të ofertave teknike në kërkojmë që në përmbajtje të propozimit të tyre të jenë trajtuar domosdoshmërisht temat e mëposhtme:

1. Konceptimi i procesit për mbështetjen e të cilit do të shërbeje sistemi i integruar WEB-GIS i aseteve dhe faturimit.
2. Arkitektura e sistemit Web-GIS
3. Specifikime teknike të aplikacioneve (Funksionet e sistemit)
4. Përshkrimi i detajuar i të objekteve dhe të dhënave që do të trajtoje sistemi
5. Konceptimi i zgjidhjeve konkrete për përditësimin e të dhënave
6. Konceptimi i zgjidhjeve konkrete për popullimin masiv të të dhënave
7. Procesi i trajnimit të personelit të Klientit
8. Aftësia për mirëmbajtjen, zhvillimin dhe ndryshimin e bazës së të dhënave e funksioneve të sistemit.
9. Kohët dhe kushtet e ofruara për shërbimin
10. Detajet mbi raportet që do të prodhohen nga sistemi
11. Kalendari i aktiviteteve
12. CV të stafit kryesor të kompanisë

6. Kërkesa te përgjithshme me karakter teknik.

Detaje te projekteve teknike qe do te ofrohen nga konkurrentët, do te përshkruhen ne propozimet e tyre teknike, por ne vëmë ne dijeni se disa kërkesa baze qe do te shërbejnë si elemente te rëndësishëm gjate vlerësimit janë:

- Ndërkohë qe kapacitetet kompjuterike dhe aftësitë profesionale ne fushën e IT ne SH.A. UK Bulqizë janë te ulëta, do te sugjeronim qe zgjidhja e duhur është ajo qe siguron ndryshimin e te dhënave nga interneti dhe gjithashtu shërbimin e hostimit te te dhënave nga vete ofertuesi.
- Sistemi i integruar Web-GIS qe do te projektohet e zhvillohet nga konsulenti, duhet te jete i lehte ne përdorim. Ai duhet te konceptohet qe te përdoret nga punonjës te UK Bulqizë qe nuk kane përdorur me pare GIS, dhe nga punonjës terreni qe nuk jene shume te kualifikuar ne teknikat e matjeve te hartave.
- Zgjidhjet ne funksion te leximit dhe te futjes se te dhënave duhet te përfshijnë përdorimin e pajisjeve kompjuterike te tipit desktop, mobile dhe tablet.
- Zgjidhjet qe do te ofrohen duhet te plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe kombëtare te Sigurisë
- Sistemi i integruar duhet te mundësojë rast nevojë, ndërveprueshmërisë ne kohe reale te informacionit te UK Bulqizëme baza te tjera te dhënash dixhitale qe janë me standarde te ndërveprimit.
- Sistemi i integruar qe do te projektohet e zhvillohet nuk do te ketë kosto te tjera liçensash për UK Bulqize përveçse ato qe përcaktohen ne ketë oferte teknike dhe financiare.
- Sistemi duhet te mundësojë “backup” periodik të të dhënave.
- Ne aspektin hartografik sistemi duhet te përdorë hartat baze nga gjeoportali zyrtar i ASIG dhe gjithashtu te përdorë sistemin shtetëror zyrtar te koordinatave KRGJSH 2010
- Sistemi duhet te mundësoje trajtimin e te gjithë tipave të të dhënave (gjeometri, dokumente, imazhe, te dhëna alfanumerike).
- Sistemi duhet te ketë mundësi te ruaje historikun e ndryshimit te informacioneve.
- SH.A.UK Bulqizë parashikon qe te realizoje agjentin tatimor ne funksion te taksave te Bashkisë Bulqize. Është një kërkesë shume e rëndësishme qe sistemi i integruar qe kërkohet te projektohet dhe realizohet duke lejuar mundësinë qe te përdoret për mbledhjen e taksave te bashkisë dhe veçanërisht për mbledhjen e taksës se pasurisë.

7. Kërkesa te përgjithshme teknike për modulën e menaxhimit gjeografik te aseteve.

Për komponentët qe lidhen me regjistrimin dhe menaxhimin e aseteve te UK Bulqizë, kërkohet qe përveç detajeve dhe shpjegimeve qe vete ofertuesi do te jete i lire ti beje ne propozimin e tij

teknik, ne kërkojmë qe detyrimisht ne propozimin teknik te përcaktohen dhe sqarohen qarte:

- Lista e plote e te gjitha objekteve (entiteteve) qe parashikohet te përmbajë baza e te dhënave. (Ne parashikojmë qe te kemi mundësi te regjistrojmë objektet qe nga niveli i burimeve ujore e deri tek elementet me te detajuar te rrjeteve si bashkuesit e linjave fundore.
- Ne propozimin teknik kërkohet qe te sqarohen te plota te gjitha atributet pse secilin prej entiteteve (Objekteve te sistemit)
- Kërkohet te behet e qarte ne propozimin teknik se si do te grumbullohet e do te mirëmbahet ne baze te dhënash i gjithë informacioni qe do te shërbeje për projektimin e llogaritjen e karakteristikave teknike te rrjetit te ujësjellësit apo si do te mbahet informacioni qe mundëson llogaritjet e presioneve ne rrjet.
- Kërkohet qe ne propozimin teknik te përcaktohet qarte se si do te pasqyrohet ne sistemin gjeografik përgatitja e paraqitja e projekteve te reja, si do te mbahen shënimet për procesin e mirëmbajtjes se rrjeteve etj.
- Ne propozimin teknik do te duhet te sqarohen qarte te gjitha funksionalitetet baze te punës me hartat te cilat parashikohet te mundësohen nga sistemi i integruar Web-GIS
- Ne propozimin teknik te sqarohen ne mënyre te veçante te gjitha funksionalitet qe lidhen specifikisht me hedhjen e te dhënave gjeografike për rrjetet e ujësjellës kanalizimeve.
- Ofertuesi duhet te sqaroje ne propozimin teknik se si sistemi do te lejoje fleksibilitet dhe pasurim te numrit te raporteve qe duhet te krijohen nga baza e te dhënave qe do te krijohet
- Ofertuesi do te duhet te sqaroje plotësisht se si do te behet integrimi i komponentëve gjeografike te asetave me sistemin e faturimit dhe menaxhimin e nevojave te klientëve
- Pjese e komponentit gjeografik do te duhet te jete lidhja e klientëve me sistemin zyrtar te adresave. Ofertuesi duhet te sqaroje qartësisht se si sistemi do te beje te mundur lidhjen e klientit dhe faturës me adresën e sakte.
- Kërkohet qe ne propozimin teknik ofertuesi te sqaroje plotësisht se si do te realizohet monitorimi i aktivitetit te popullimit te te dhënave

8. Kërkesa te përgjithshme teknike për modulin e faturimit

Kërkesat tona për sistemin e faturimit janë jo me shume se sistemet faturimit qe sot ekzistojnë ne tregun shqiptar. Por gjithsesi ne kërkojmë qe ne përmbajtje te propozimit teknik te trajtohen deri ne detaje temat e mëposhtme:

Objekti kryesor i këtij moduli duhet te përfshije realizimin e qëllimeve qe lidhen me administrimin e abonentëve, faturimit, arkëttimeve, ankese / kërkesave si dhe printimit te faturave apo komponentë dhe shërbime te tjera.

Sqarimet e detajuar qe do te duhet te bëhen ne propozimin teknik duhet te paktën te mbulojnë temat e mëposhtme:

- Administrimi i Abonentit -- Qëllimi i administrimit te abonentit eshte per te rritur

aftesine e ndermarrjes qe te identifikojte sakte klientet e saj dhe te respektojte kontraten e furnizimit me uje dhe kanalizime.

- Administrimi i Faturimit -- Qellimi i administrimit te faturimit eshte per te rritur aftesine e ndermarrjes qe te realizojte leximet ne nje kohe sa me te shkurter, te rrise transparencen e leximeve si dhe te printojte ne kohe faturat tatimore.
- Administrimi i Arketimit -- Qellimi i administrimit te arketimeve eshte per te rritur performancen e ndermarrjes qe te lehtesojte procesin e arketimit per punonjesit si dhe shtojte kanalet e pagesave.
- Administrimi i Akt-Marrveshjeve -- Qellimi i administrimit te akt-marrveshjeve eshte per te rritur sherbimet dhe mundesite qe ndermarrja ofron per abonentet e saj.
- Administrimi i Ankese / Kerkesave -- Qellimi i administrimit te ankese/kerkesave eshte per te rritur transparencen e ndermarrjes si dhe administrimin e informacionit te ankese kerkesave ne menyre korrekte.
- Funkcionalitete te tjera si raportimet etj,
- Import eksportet e te dhenave

9. Kushte te pergjithshme te sherbimit qe kerkohet

Ne esence te konsulencës dhe sherbimit qe kerkohet qendron ideja qe pergjegjesinë e vazhdueshme për mirëfunktionimin e sistemit te integruar Web-GIS, dhe mirëmbajtjen e sigurinë e bazës se te dhënave do ta ketë Konsulenti. Konsulenti do te duhet te parashikojte qe ai do te kryejte asistencë te vazhdueshme teknike dhe do te beje vazhdimisht ndryshime ne sistem qe ndikohen nga ndryshimet e ligjit apo akteve nënligjore dhe ndikojnë ne procesin e punës se UK Bulqizë. Konsulenti do te mare përsipër te gjitha këto pergjegjësi brenda kushteve financiare te ofruara prej tij. SH.A.UK Bulqizë është pronare e te gjitha dhënave qe krijohen nga vete ajo. SH.A.UK Bulqizë do te ketë te drejtën ti posedojte “buck up” (kopje) të të dhënave te veta ne çdo kohe qe ajo te dëshiroje

Te gjitha hartat baze qe do te përdoren si mbështetje hartografike e procesit dhe qe do te shërbehen nëpërmjet sistemit Web-GIS si shtresa te veçanta informacioni do te përpunohen (skanohen, gjeo-referohen, përgatiten) nga Konsulenti dhe do te shërbehen nga sistemi Web-GIS si detyrim i tij dhe brenda çmimit te ofruar prej tij.

Konsulenti siguron UK Bulqizë qe sistemi dhe baza e te dhënave funksionojnë sipas termave te kontratës ne serverët/serverin e siguruar nga vete Konsulenti.

Konsulenti siguron UK Bulqizë se është i afte dhe i disponoheshim ne çdo kohe qe te ndryshojte vendndodhjen e bazës se te dhënave apo te programeve sipas kërkesës se mundshme te klientit dhe sipas kushteve te rena me pare dakord ne kontrate. Ne rast të një kërkesë nga SH.A.UK Bulqizë për një vendndodhje të serverëve, bazës se të dhënave dhe aplikacioneve ndryshe nga

ajo qe ka siguruar Siguruesi i Shërbimit, koston e hardware dhe garancinë e funksionimit të tyre, përfshire cilësinë dhe garancinë e shërbimit me internet e ka SH.A.UK Bulqizë.

Përdoruesit e sistemit janë te pakufizuar ne numër. Ne rastet kur numri i përdoruesve qe përdorin sistemin është i lidhur me koston e licencave te programeve apo platformave te ndryshme, kostoja e tyre do te jete përgjegjësi e Konsulentit si pjese e çmimit te shërbimit.SH.A.UK Bulqizë do te kete te drejtën e administrimit te plote te përdoruesve te sistemit te integruar Web-GIS.

Kushte te këtij shërbimi do te jete Interesi i vazhdueshëm i Konsulentit për te ndihmuar punonjësit e UK Bulqizë, ne fushën e kuptimit dhe përdorimit te vazhdueshëm te sistemit, përmirësimit te shërbimit, trajnimit gjate punës te punonjësve te klientit. Konsulenti do te jete i detyruar te realizoje ketë aktivitet gjate gjithë periudhës se shërbimit.

10. Aktivitetet e pritshme dhe kalendari i aktiviteteve.

Përshkrimi i aktiviteteve te detajuara dhe plani i realizimit te tyre do te jene specifike sipas përpilimit te ofertuesit por është e pritshme qe ato te jenë si me poshtë:

1. Analiza e detajuar e aktivitetit dhe gjendjes ne UK Bulqizë.
2. Diskutimet me stafin e UK Bulqizë dhe vendimmarrja mbi projektin përfundimtar te sistemit te integruar
3. Zhvillimi i sistemit + Trajnimi i përdoruesve
4. Vënia ne funksion
5. Mirëmbajtja dhe asistenca e vazhdueshme ne funksion te trajnimit dhe ndryshimeve.

Ne përmbajtje te propozimit teknik kërkohet lista e detajuar e aktiviteteve qe do te realizoje kompania dhe plani kohor i realizimit te tyre.

11. Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Mënyra dhe vendi i ofrimit te shërbimeve do te përcaktohen te detajuara sipas llojit te aktiviteteve qe do te realizohen ne ketë kontrate. Ndërkohe qe shume aktivitete mund te realizohen online kërkohet qe ne fazën fillestare te analizës dhe projektimit vendi i realizimit te shërbimit te jete ne Bashkinë Bulqizë

12. Oferta financiare

Oferta financiare kërkohet te përpilohet ne formën e tabelës se mëposhtme.

1	2	3	4	5	6
Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi (lek)/Njësi	Çmimi Total	Afati
1	Analiza, Projektimi, Zhvillimi i sistemit	1			
2	Mirëmbajtje, hostim, shërbim, asistencë teknike, trajnim.	4 vjet	Çmimi /1 vit		4 vjet
			Çmimi neto (lek)		
			Tvsh (Lek)		
			Çmimi Total		